




		<b>REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT</b> <b>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
Dep.	20/DPK	Nr. Prot.	01-4243/15
Dep.		Bi Prot.	
Dep.		Prot No	
Nr. I faq		Data	
Broj stranica	02	Datum	
Nr. pages		Date	18.11.2015
PRISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 18.11.2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-02-2930-15 për z.Sahit Abazi –Këshilltar komunal në Komunën e Gjilanit, për shkak se ështëshmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2930-15, për Zyrtarin e lartë, z.Sahit Abazi-Këshilltar komunal në Komunën e Gjilanit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z.Abazi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit, pas të cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Abazi është deklaruar se brenda afatit ligjor, do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjell një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-02-4045/15), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se te biznesi individual N.T.“Trend Light-GJ”, z. Abazi tashmë është hequr nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencise Kundër Korruptionit



/ Hasan Preteni